



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:117453
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06105514

K.DH.SH.II.nr.1490/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësi-propozuesit të masës së sigurisë Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë sheshi “Nëna Terezë” nr.36, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.K., kundër kundërshtarëve të sigurimit 1.) E.H.K. D.O.O., me seli në Mitrovicë Rr.”...” dhe 2.) Komuna e Prishtinës të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D.GJ., duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit-propozuesit të masës së sigurisë të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Përgjithshëm, KP.nr.18/24 të datës 12.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditësit-propozuesi të masës së sigurisë Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, detyrimisht Anullohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Përgjithshëm, KP.nr. 18/24 të datës 12.07.2024, dhe lënda i kthehet në Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti të Përgjithshëm në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Përgjithshëm, është vendosur si në vijim;

I. “REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar propozimi i propozuesit Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë., me të cilën ka kërkuar që ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1.) E.H.K. D.O.O., me seli në Mitrovicë dhe 2.) Komuna e Prishtinës, të caktohet masa e sigurisë dhe t’iu ndalohet që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë, disponojë, apo ndërmarr çfarëdo veprimi me qëllim të përfitimit në përdorim, apo për ndryshimin e gjendjes ekzistuese në pasurinë- parcelën dhe objektet e ndërtaura në parcelën me numër të njësisë së ndërtesës 0-71914059-7122-1-36-0, rruga “...” në parcelën me numër 7122-6 Zona Kadastrale Prishtinë.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi-propozuesi i masës së sigurisë , për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë i gjendjes faktike, si dhe për shkak aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe të aprovohet në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës secilin veç e veç dhe analizës së tyre si dhe pas shqyrtimit të aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurisë, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës, me seli në Prishtinë, më datën 12.04.2024, në këtë Gjykatë ka parashtruar padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1.) E.H.K. D.O.O., me seli në Mitrovicë dhe 2.) Komuna e Prishtinës, me propozimin që të aprovohet propozimi si i bazuar dhe të caktohet masa e sigurisë. Ndërsa me datën 24.05.2024, ka dorëzuar precizimin e propozimit për caktimin e masës së sigurisë, me propozimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se propozuesi i masës nuk kanë arritur ta bëjnë të besueshme plotësimin e dy kushteve kumulative siç përcaktohet me ligj, përkatësisht ekzistimin kërkesës apo të drejtës subjektive të propozuesit, me as një provë nuk është vërtetuar e drejta subjektive e propozuesit, ndërsa me as një provë nuk kanë arritur të argumentojnë se ekziston rreziku apo dëmi që mund ti shkaktohet si në propozim për caktimin e masës së sigurisë, gjegjësisht propozuesit e masës me as një provë nuk vërtetoi se caktimi i kësaj mase do të kishte bazë ligjore konform nenit 297 par.1, pika a) dhe b) të LPK-së. Ndër të tjera ka cek se në bazë të së cilave propozuesi i masës e bazon propozimin për caktim të masës së sigurisë, gjykata gjeti se këto pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimi lidhur me vendosje për masë të sigurisë, pasi që të njëjtat janë objekt shqyrtimi sipas padisë. Po ashtu ka cek se gjykata ka vlerësuar pretendimet mbi të cilat në rastin konkret është kërkuar që të vendoset masa e sigurimit por nuk janë bërë të besueshme dhe nuk janë të bazuara, nga fakti se propozuesi nuk i ka ofruar prova të besueshme gjykatës, se në rast se masa e sigurimit nuk caktohet, ai do të ketë dëme apo vështirësi në realizimin e kërkesës.

Ankuesi-propozuesi ka cek se është në posedim të pa pengushëm një kohë shumë të gjatë, dhe për objektin-lokalin afarist ka paguar rregullisht tatim. Ankuesi me tutje thekson se gjykata e dhomës së shkallës ë parë e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe si rrjedhojë saj ka ardh edhe deri te shkelja e të drejtës material, më konkretisht të udhëzimit të Gjykatës Supreme në Republikën e Kosovës dhe në fund ka kërkuar që të ndalohet, tjetërsimi fshehja, shitja, si dhe të ndalohet çfardo veprimi lidhur me ndryshimin e gjendjës ekzistuese të lokalit afarist të precizuar në parcel me nr. 0-71914059-7122-1-36-0 rruga S.V. e regjistruar në parcelën 7122-6ZK-Prishtinë.

Dhoma e Shkallës ë Dytë pasi që e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar si dhe pretendimet ankimore të propozuesit gjeti se aktvendimi në fjalë duhet të priset detyrimisht dhe çështja të kthehet Gjykatës Komerciale Dhoma e shkallës së parë Departamenti i Përgjithshëm në rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë në rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës KP.18/24 gjeti çertifikatën e pronësisë të lokalit afarist me numër e të dhëna tjera të cekura në aktvendimin ankimuar dhe nga përmbatja e çertifikatës së pronësisë shifet se kemi të bëjmë së pari me lokal afarist e cila ka qenë në pronësi shoqërore të ndërmarrjës E.H.K. D.O.O me seli në Prishtinë. Pra nuk kemi të bëjmë me çështje banesore siç pretendon ankuesi-propozuesi duke u thirë në

udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Tani për tani për gjykatën e dhomës së shkallës së dytë është e pa qartë fakti se ky lokal afarist ka qenë si pronë shoqërore e korporatës E..H.K.. D.O.O me seli në Mitrovicë gjatë vitit 1999 e pastaj kjo korporatë a ekziston më në territorin e Republikës së Kosovës apo në Republikën e Sërbisë, në fakt kundërshtari i sigurimit pretendohet E.H.K. D.O.O me seli në Mitrovicë. Nën supozimin se kemi të bëjmë me pronë shoqërore e cila është në territorin e Republikës së Kosovës e sipas rregullave të UNMIK-ut-përfaqësues për çdo çështje për mardhënie juridike që kanë të bëjnë me prona shoqërore është Agjencia Kosovare e Privatëzimit me seli në Prishtinë. Kështu rrjedhëmisht nga kjo se paditës dhe i paditur për prona shoqërore është Agjencioni Kosovar i Privatëzimit me seli në Prishtinë, andaj si rrjedhojë e kësaj vëhet në pyetje legjitimiteti aktiv e palës paditëse në rastin konkret. Andaj nga të cekurat më lartë kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e rishqyrtimit Gjykata e dhomës së shkallës së parë duhet së pari ta vërtetoi faktin se korporata E.H.... a është korporatë shoqërore që ka qenë më seli apo është në Republikën e Kosovës, pastaj gjykata ta vërtetoi faktin se kjo pronë shoqërore nëse është shoqërore për të qenë paditës apo i paditur a është agjencia kosovare e privatezimit. Kur të vërtetohet ky fakt qenësor atëherë gjykata të vendos për legjitimiteti e padisë dhe për propozim për caktimin e masës së sigurisë. Po ashtu të siguroj edhe kontratën mbi shitëblerjen e cila është evidentuar në kataster.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1490/24 datë 29.08.2024.

**Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri**